

VENDIM
Nr. 615, datë 31.8.2016

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 7.4.2016, PËR ÇËSHTJEN “ALIÇKA DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË” (PËR ANKIMET NR. 33148/11, NR. 33151/11, NR. 33823/11, NR. 46103/11, NR. 72334/11 DHE NR. 78960/11)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.4.2016, për çështjen “Aliçka dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për ankimet nr. 33148/11 (Aliçka dhe Vasha), nr. 33823/11 (Tahiri), nr. 46103/11 (Theodhosi), nr. 72334/11 (Nishe dhe të tjerë), nr. 78960/11 (Benussi), sipas listës së ankuesve në shtojcën 1 dhe shumat e përcaktuara në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi dhe që janë pjesë përbërëse e tij, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Në zbatim të vendimit të GJEDNJ-së, të bëhet ekzekutimi, me mjete të përshtatshme, i vendimeve të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të dhëna në favor të ankimit nr. 33151/11 (Kreka), në raport me pjesën takuese të ankuesit, brenda 3 muajve nga data e vendimit të GJEDNJ-së.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, gjatë ekzekutimit të vendimit të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

4. Vlerat e përcaktuara si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.4.2016, për secilën çështje.

5. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të ankuesve “Aliçka dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për ankimet nr. 33148/11 (Aliçka dhe Vasha), nr. 33823/11 (Tahiri), nr. 46103/11 (Theodhosi), nr. 72334/11 (Nishe dhe të tjerë), nr. 78960/11 (Benussi), të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor, për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda 3 muajve nga data që vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

6. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 5, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

7. Efektet financiare, të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontingjencës i buxhetit të shtetit.

8. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1
LISTA E APLIKANTËVE

Nr.	Titulli i çështjes dhe nr.	Emri i aplikuesve (viti i lindjes)	Vendbanimi	Përfaqësuar nga	Data e paraqitjes
1.	<i>Aliçka dhe Vasha</i> , nr. 33148/11	Velisha Aliçka (1940) Adriatik Aliçka (1949) Nafije Vasha Aliçka (1942)	Shqipëri Shqipëri Shqipëri	S. Dodbida, avokat	17 maj 2011
2.	<i>Kreka</i> , nr. 33151/11	Selami Kreka (1925)	Shqipëri	Asnjë	13 maj 2011
3.	<i>Tabiri</i> , nr. 33823/11	Dilaver Tahiri (1944)	Shqipëri	V. Gumi, avokat	24 prill 2011
4.	<i>Theodhosi</i> nr. 46103/11	Afërdita Theodhosi (1951)	Shqipëri	Asnjë	6 korrik 2011
5.	<i>Nishe dhe të tjerë</i> nr. 72334/11	Petraq Nishe (1938) Irimi Shkurti Nishe (1936) Josif Nishe (1938) Ilia Çili (1954) Margarita Tola Çili (1957) Sotir Çili (1962)	Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri	S. Dodbiba, avokat	5 tetor 2011
6.	<i>Benussi</i> , nr. 78960/11	Anton Benussi (1938)	Shqipëri	S. Puto, avokat	12 mars 2012

SHTOJCA 2
SHPËRBLIMI I DREJTË

Nr.	Emri i aplikimit dhe numri	Dëmi pasuror dhe jopasuror	Kostot dhe shpenzimet
1.	<i>Aliçka dhe Vasha</i> , nr. 33148/11	3200 (tre mijë e dyqind) euro	Asnjë (nuk është paraqitur faturë)
2.	<i>Kreka</i> , nr. 33151/11	Asnjë	Asnjë (nuk është paraqitur faturë)
3.	<i>Tabiri</i> , nr. 33823/11	34,300 (tridhjetë e katër mijë e treqind) euro	850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro
4.	<i>Theodhosi</i> , nr. 46103/11	11,800 (njëmbëdhjetë mijë e tetëqind) euro	Asnjë (nuk është paraqitur faturë)
5.	<i>Nishe dhe të tjerë</i> , nr. 72334/11	31,300 (tridhjetë e një mijë e treqind) euro	Asnjë (nuk është paraqitur faturë)
6.	<i>Benussi</i> , nr. 78960/11	719,000 (shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë) euro	850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro